

EKSTRAKT- VENDIMI

“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur”

Ankuesi i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me një ankesë, në të cilën nuk ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratëve, por ka lidhje me shefin e regjimit të një I.E.V.Penale, me ndërprerjen e takimeve familjare si dhe izolimin e tij në regjimin 41 bis, në I.E.V.Penale ku ankuesi vuan dënimin e caktuar nga gjykata. Gjithashtu me anë të kësaj ankese, ai ngre pretendimin se i është bërë padrejtësi pasi nuk ka kontakte me njerëz të inkriminuar as brenda dhe jashtë burgut, si dhe të jetë i përfshirë në një aktivitet kriminal.

Referuar kushteve të pranueshmërisë së ankesës rezulton, se ajo është bërë në formën e përcaktuar të nenit 120/1 shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi përmban gjeneralitetet e ankuesit dhe adresën e tij, si dhe përshkruan rrethanat e faktit që pretendohen të kenë ndodhur.

Ndërsa përsa i përket pretendimeve të ankuesit, vlerësohet se nuk janë objekt i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi nuk ka pretendime për veprimtari të ushtruar nga magjistratë, kjo referuar nenit 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë referuar nenit 120, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121 pika 2 shkronja “a” të këtij ligji.

Për këto arsye,

Bazuar në nenin 120 pika 1, nenin 121 pika 2/a të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar,

VENDOSA

1. Arkivimin e ankesës së ankuesit, rregjistruar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj veprimtarisë së I.E.V.Penale.
2. Përcjelljen e një kopje të ankesës për trajtim organit kompetent, Ministrisë së Drejtësisë.
3. Në zbatim të nenit 121 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ky vendim t`i njoftohet ankuesit brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

4. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor/të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e këtij vendimi.

EKSTRAKT- VENDIMI

“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur”

Ankuesi ka depozituar ankesën e tij pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, e cila është përcjellë për kompetencë trajtimi pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ku parashtron se ka paraqitur një kërkesë-ankesë për monitorim të një kallëzimi penal të bërë nga ana e tij në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ndaj një ish-gjyqtari.

Në kallëzimin penal ankuesi pretendon se ish-gjyqtari me të cilin është bashkëpronar i një prone truall, me anë të veprimeve korruptive nuk e lejon të shfrytëzojë pjesët e tij të ndërtimit që i takojnë si dhe, i ka vjedhur duke ushtruar dhunë, ndërtimet e zhvilluara në truallin ku ai me ankuesin është bashkëpronar. Gjithashtu ankuesi pretendon se ish-gjyqtari ka tentuar ta vrasë me mjete të forta nëpërmjet një personi të afërt të tij, gjë e cila ka mbetur në tentativa dhe se ish-gjyqtari është drejtues i një grupi të strukturuar kriminal, ku të ardhurat e këtij grupi burojnë nga veprimtaria e paligjshme nëpërmjet aferave korruptive të ish-gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

Referuar kushteve të pranueshmërisë të parashikuara në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar rezulton se ajo është paraqitur në formën e përcaktuar në nenin 120/1/a të këtij ligji, pasi përmban gjeneralitetet dhe adresën e ankuesit, përshkruhen rrethanat dhe faktet që pretendohen të kenë ndodhur si dhe përmban emrin, mbiemrin dhe gjykatën pranë së cilës ka ushtruar funksionin e tij ish-magjistrati.

Lidhur me pretendimet në ankesë, ato nuk lidhen me ndonjë vendim apo drejtpërsëdrejti me veprimtarinë gjyqësore të ish-gjyqtarit, por ato lidhen me veprimtarinë jashtë ushtrimit të funksionit si ish-gjyqtar.

Nisur nga shqyrtimi fillestar i ankesës në drejtim të verifikimit të pranueshmërisë, rezulton se ish-gjyqtari nuk është më subjekt verifikimi, pasi ai nuk gëzon statusin e magjistratit, për shkak se është dorëhequr nga detyra e gjyqtarit, dhe se në kohën e ushtrimit të detyrës ndaj tij nuk kishte filluar ndonjë proces hetimi disiplinor, duke mos u plotësuar kushti i pranueshmërisë së ankesës referuar nenit 120, pika 1, shkronja ç e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ndërsa përsa i përket pretendimeve të ankuesit për monitorim të një kallëzimi penal të bërë nga ana e tij ndaj ish-gjyqtarit, ky pretendim nuk është objekt verifikimi i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kjo referuar nenit 194, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, vlerësohet se ankesa e ankuesit nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë referuar subjektit ndaj të cilit ajo drejtohet, parashikuar nga neni 120, pika 1, shkronja ç të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe objektit të saj në lidhje me nenin 194, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemi të drejtësisë” i ndryshuar, për rrjedhojë ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121, pika 2, shkronja a të këtij ligji.

Për këto arsye,

Bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja “ç”, nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 194, pika 1, si dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar,

VENDOSA

1. Arkivimin e ankesës së ankuesit, rregjistruar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj veprimtarisë së magjistratit.
2. Urdhërohet njoftimi i këtij vendimi ankuesit.

Ankuesi, brenda 1 jave nga marrja e këtij vendimi, mund të paraqese ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

EKSTRAKT- VENDIMI

“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur”

Ankuesi ka depozituar dy ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat janë përcjellë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për trajtim. Në ankesa janë ngritur pretendime për procese të parregullta ligjore të zhvilluara nga trupa gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, si dhe nga trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit, për arsye se vendimi i rrëzimit të padisë i Gjykatës së Rrethit, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, si dhe në çështjet gjyqësore të ngritura nga ankuesi në të dyja gjykatat me objekte të ndryshme, ai pretendon se vendimet e dhëna janë rezultat i hetimeve jo të plota, njëanshmëri në dhënien e vendimeve, gjithashtu citon faktin se gjykata nuk ka pasur parasysh dispozitat e ligjit procedural dhe material si dhe jurisprudencën e gjykatës më të lartë.

Ndër të tjera ankuesi ngre pretendime për veprime të kundërligjshme si të gjyqtarëve ashtu edhe të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, pasi kjo e fundit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për një përmbarues privat. Për këto arsye ankuesi është bindur se trupat gjyqësore të gjykatave të sipërcituara nuk mund të japin vendime të drejta lidhur me çështjet objekt gjykimi për shkak se kanë cënuar besimin e tij te drejtësia.

Nisur nga fakti se ankesat janë të të njëjtit ankues dhe drejtohen ndaj të njëjtëve magjistratë për të njëjtat fakte nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është miratuar urdhëri për bashkimin dhe trajtimin e përbashkët të ankesave në të njëjtin akt.

Referuar kushteve të pranueshmërisë të parashikuara në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar rezulton se ato janë paraqitur në formën e përcaktuar në nenin 120/1/a të këtij ligji, pasi përmbajnë gjeneralitetet dhe adresën e ankuesit, përshkruhen rrethanat dhe faktet që pretendohen të kenë ndodhur si dhe përmbajnë emrin, mbiemrin dhe gjykatën pranë së cilës ushtrojnë funksionin e tyre magjistratët.

Ndërsa përsa i përket mospërmbushjes së kriterit të papranueshmërisë në të dyja këto ankesa janë: 1- Në kohën e paraqitjes së ankesave në KLGJ, afati 5 vjeçar i parashkrimit të shkeljes disiplinore kishte kaluar. 2- Pretendimet ndaj vendimmarrjes së gjykatave, janë pretendime të cilat zgjidhen mbi bazë apelimi gjyqësor nga gjykata më e lartë. 3- Referuar interpretimit të ligjit nr. 96/2016, çdo procedure e kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë derisa nuk ka filluar hetimi disiplinor, përfundon në rast se magjistrati nuk ushtron më detyrën me vendim të organit kompetent duke sjellë arkivim të ankesës.

Të gjitha pretendimet e ankuesit ndaj veprimtarisë gjyqësore të paraqitur gjatë gjykimit i janë nënshtruar shqyrtimit, vlerësimit dhe vendimmarrjes së gjykatave respektive, si kërkesat për përjashtimin e tyre, ashtu dhe kërkesat procedurale për ecurinë e gjykimit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë ushtrimit të kompetencave të veta, ndër të tjera udhëhiqet edhe nga parimi i respektimit të pavarësisë së magjistratit në ushtrimin e detyrës, duke shmangur çdo lloj perceptimi si ndërhyrje në kompetencë apo për zgjidhje të çështjes konkrete.

Për rrjedhojë pretendimet e ankuesit nuk janë të natyrës që përbëjnë shkelje disiplinore sipas përcaktimeve të neneve 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në këto kushte ankesat nuk përmbushin kriterin e pranueshmërisë parashikuar nga neni 120, pika 1, shkronja b, ç, d, dh, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në ankesa mungojnë dyshime të arsyeshme të cilat të justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj tyre për ndonjë shkelje disiplinore konkrete, prandaj ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121, pika 2, shkronja a të këtij ligji.

Për këto arsye,

Bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja “b”, “ç”, “d”, “dh”, nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar,

VENDOSA

1. Arkivimin e ankesës së ankuesit, rregjistruar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj veprimtarisë së magjistratëve.
2. Në zbatim të nenit 121, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ky vendim t’i njoftohet ankuesit dhe magjistratëve brenda 5 ditëve nga marrja e tij.
3. Kundër këtij vendimi, akuesi, mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e këtij vendimi.